



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Me qëllim të promovimit të Kosovës si destinacion turistik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në bashkëpunim me donatorët USAID/EMPOWER Project dhe Swisscontact| Promoting Private Sector Employment (PPSE), shpallë:

Ftesë për shprehje të interesimit për pjesëmarrje në stendën e përbashkët të Kosovës në Panairt: “ITB Berlin”, që mbahet në Berlin, 8–12 Mars 2017 dhe “Destination Nature”, që mbahet në Paris, 16-19 Mars 2017.

Kosova, edhe këtë vit do të marrë pjesë me stendë të përbashkët në panairt më të madha të turizmit në nivel bote dhe shumë strategjik për vendin tonë: ITB Berlin, i cili do të mbahet në Berlin të Gjermanisë dhe Destination Nature, i cili do të mbahet në Paris të Francës.

Stenda e përbashkët do të organizohet dhe do të mbështetet financiarisht nga MTI/KIESA, projekti USAID (Empower) dhe projekti Swisscontact (PPSE). Mbështetja financiare do të mbulojë shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin dhe dizajnin e shtandit, regjistrimin e kompanive, shpenzimet për rrymë, pastrim ditor etj., dërsa akomodimit dhe dërgimin e materialeve promovuese do të merren përsipër nga kompanitë pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re: se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë **02.02.2017** do të shqyrtohen për vlerësim dhe vetëm pyetësorët e plotësuar tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në KIESA **më 31 Janar**, duke filluar nga ora 10:00 gjerë në ora 12:00, ekspertët e KIESA-së dhe ata të donatorëve do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e stendës së përbashkët në grup. Kompanitë që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë.

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (në sallën e agjencisë) **pas përfundimit të shqyrtimit të aplikacioneve**, do të zhvillohet procesi i intervistimit të kompanive të cilat kanë shprehur interesim për pjesëmarrje në panairin botërorë të destinacioneve ITB Berlin dhe të turizmit alternativë Destination Nature.

Aplikimi: Kompanitë që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar pyetësorin dhe ta dërgojnë atë më së largu deri më **02 shkurt** në e-mail adresën: kreshnik.rugova@rks-gov.net ose në Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/KIESA, Rruga: Muharrem Fejza, Lagjja e Spitalit, pa Nr. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Informacionet dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merret në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë/KIESA, mund të shkarkohet nga ueb faqet: www.mti-ks.org, ose në formën elektronike nga zyrtari përgjegjës: kreshnik.rugova@rks-gov.net.

Në bazë të këtij pyetësori është hartuar edhe matrica për përzgjedhjen e kompanive, dhe nga rezultatet përfundimtare, do të përzgjidhen kompanitë me pikët më të larta.